

Ministria e Arsimit në bashkëpunim me WUS-Austria kanë filluar seminarin dyditor me temë "Programet e Përbashkëta dhe Njohja Akademike", me qëllim të njohjes me zhvillimet e fundit në fushën e arsimit të lartë

Drita VITIA  
Prishtinë, 7 korrik

**M**e qëllim të njohjes me zhvillimet më të fundit në fushën e arsimit të lartë, zhvillimit të programeve të përbashkëta, trendëve aktuale në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, Ministria e Arsimit në bashkëpunim me organizatën WUS Austria ka filluar seminarin dyditor. Avdullah Alija në emër të Ministrit të Arsimit, Enver Hoxhaj, të pranishmit i

*Kurse, Christian Geosits nga Austria, ndër të tjera ka thënë se WUS - Austria është e përkushtuar që edhe më tej të mbështes zhvillimet programore dhe ndërkombëtarizimin e Arsimit të Lartë të Kosovës. Punimet e këtij seminari do të vazhdojnë edhe të enjten ku pritet të dalin edhe rekomandimet.*

NDËRKOMBËTARIZIMI I ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË

## Njohje ndërkombëtare e arsimit të lartë



ka falënderuar për kontributin e tyre, Qeverinë e Austrisë përkatësisht Organizatën Joqeveritare WUS-Austria, që është zbatuese e projekteve arsimore në fushën e arsimit të lartë në Kosovë. "Ministria e Arsimit është fokusuar që të nxisë zhvillimin e programeve të përbashkëta, dhe njohjet reciproke Akademike në mes Ko-

sovës dhe vendeve të ndryshme të Evropës dhe në këtë kontekst Procesi i Bolonjës është qenësorë edhe për ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë", është shprehur Alija. Ndërkohë, rektori i Universitetit të Prishtinës, Mujë Rugova, ka thënë se procesi i programeve mësimore në harmoni me ato të Evropës është në zhvillim e sipër, duke

thënë se një gjë e tillë është bërë me qëllim që diplomat e UP-së të jenë të barasvlershme me ato evropiane. Ai ka thënë se Organizata Joqeveritare EUS, e specializuar për implementim të programeve, ka zhvilluar dhe zbatuar në Universitetin e Prishtinës më shumë se 100 lëndë të reja mësimore si dhe katër programe master.